

RAPORT

i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) për verifikimin e standardeve për ristrukturimin e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” (UMSH)

I. Plani i takimeve të GVJ

GVJ i ngritur nga BA kreu vizitën pranë UMSH më datë 29 Maj 2018 dhe i realizoi të gjitha takimet e parashikuara sipas planit të miratuar nga ASCAL dhe UMSH.

II. Dokumentet në dispozicion të grupit “ad-hoc”

Dokumentet që u vunë në dispozicion të GVJ janë:

1. Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Sportit Nr. 273, datë 18.05.2017 për “Hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike dhe riorganizimin e njësisë kryesore nga “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare” të shkollës së lartë private “Mesdhetare e Shqipërisë”;
2. Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Sportit Nr. 278, datë 19.05.2017 për “Miratimin e statutit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”;
3. Urdhër i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 140, datë 26.03.2018 për “Miratimin e ndryshimeve të statutit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”;
4. Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore) për regjistrimin e formave të diplomave të lëshuara nga UMSH, nga 2 fakultetet, respektivisht i riorganizuar dhe krijuar rishtaz;
5. Vendimi Nr. 4 datë 15.06.2018 për emërimin e Rektorit të UMSH;
6. Raportin e vlerësimit të pronës, bërë më datë 20.11.2017;
7. Raportin e verifikimit të godinës, bërë më datë 20.11.2017;
8. Rregulloret e fakulteteve dhe departamenteve në UMSH;
9. Struktura organizative e UMSH përpara dhe pas ndryshimeve;
10. Të dhëna për stafin akademik të UMSH;
11. Të dhëna për programet e studimit që ofrohen nga UMSH;
12. Draft-Plani Strategjik i Institucionit dhe kërkimit shkencor për ciklin e tretë të studimeve;
13. Lista e lëndëve ku angazhohet stafi i Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë;
14. Të dhëna për numrin e studentëve në fakultetin e ri dhe atë të riorganizuar;
15. Vendim i Bordit të Administrimit për fondin e shpërblimeve.

III. Gjendja e infrastrukturës së UMSH

Mbështetur në raportin e kontrollit të MASR, rezulton se UMSH plotëson kriteret ligjore infrastrukturore për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

IV. Autoritetet akademike të UMSH

UMSH ka Senatin e tij, Bordin (e administrimit) si edhe Këshillat në çdo fakultet. Këto autoritete ushtrjnë funksionet e tyre në përputhje me statutin e institucionit dhe rregulloret e brendshme të tij.

Mbështetur në Vendimin e Bordit të UMSH, Nr. 4 datë 15.06.2018, Rektori i UMSH, është Z. Gudar Beqiraj, i cili ka titullin Akademik në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.

V. Krijimi dhe riorganizimi i njësive kryesore në UMSH

Në bazë të Urdhërit Nr. 273 të Ministres së Arsimit dhe Sportit dt. 18.05.2018, UMSH ka proceduar hapjen e *Fakultetit të ri të “Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike”* dhe riorganizimin e *Fakultetit ekzistues të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare*. Në bazë të këtij Urdhëri njësia kryesore e re dhe njësia kryesore e riorganizuar kanë filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2017 – 2018.

V.1 Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike

V.1.1. Departamentet dhe programet e Studimit

Njësia kryesore e krijuar përbëhet nga tre njësi bazë:

- **Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë**
Në këtë departament ofrohen : 1 diplomë Bachelor në “Studime Psikosociale” dhe 1 diplomë Master i Shkencave në “Psikologji” me dy profile.
- **Departamenti i Shkencave Politike**
Në këtë departament ofrohen: 1 diplomë Bachelor në “Shkenca Politike” me profil: “Shkenca Politike”; 1 diplomë Master i Shkencave në “Shkenca Politike” dhe 1 diplomë Master Profesional në “Shkenca Politike” me profil: “Politikat Sociale”.
- **Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit bazë**
Në këtë departament ofrohen: 1 diplomë Bachelor në “Shkenca Politike” me profil: “Administratë Publike”; 1 diplomë Master Profesional në “Shkenca Politike”, me dy profile: “Qeverisje Vendore”; “Administratë Publike”.

Koment:

- Sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, neni 23 pika 2, në përbërje të Fakultetit (njësisë kryesore duhet të jenë 3 njësi bazë, nga të cilat minimalisht 2 duhet të jenë Departamente. Kështu që ky kriter plotësohet.
- Nga analiza e programeve të ofruara nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike vihet re se Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë nuk ofrojnë diploma, të cilat mund të lidheshin me objektivat e formimit të studentëve. Në fakt programet e propozuara si të reja janë profile të programeve të ofruara më parë në Departamentin e Shkencave Politike.
- Vetë përbërja dhe emërtimi i Departamentit të Administrimit dhe Formimit Bazë nuk duket bindës si për nga formimi dhe ekspertiza e personelit akademik të departamentit ashtu edhe nga fusha e kompetencave profesionale të studentëve (??).

V.1.2. Përbërja dhe kualifikimi i personelit akademik sipas departamenteve

1) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **9 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Asoc.
- 4 PhD.
- 1 Dr.
- 3 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **7 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 Prof.
- 3 Dr.
- 2 Msc.

2) Departamenti i Shkencave Politike

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **8 pedagogë**:

- 1 Prof. Asoc.
- 1 PhD.
- 3 Dr.
- 3 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **2 pedagogë**:

- 1 Dr.
- 1 Msc (Administratori nuk bën pjesë në stafin akademik as PAE dha as ne PAK)

3) Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 1 Prof. Asoc.
- 2 Dr.
- 4 Msc.

Nuk ka personel akademik me kohë të pjesshme të paraqitur në raport (PAK).

Koment:

- Lidhur me numrin e personelit me kohë të plotë të një departamenti (PAE), sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, duhet të jenë minimalisht 7 anëtarë me kohë të plotë. Ky kriter plotësohet për të tre departamentet.
- Nga krahasimi i përbërjes së stafit PAE dhe PAK në strukturën e vjetër të Departamentit të Shkencave Politike dhe stukturën e re të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike del se 60 përqind e stafit aktual me tituj dhe grada në departamentet e reja vjen nga rishpërndarja e pedagogëve të ish Departamentit të Shkencave Politike.
- Në dokumentat e dërguara nga UMSH nuk del qartë kualifikimi dhe fusha e ekspertizës së personelit akademik, për të vlerësuar saktë përkatësinë e formimit akademik me fushat e studimit ku janë angazhuar.

V.2 Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

V.2.1. Departamentet

Kjo njësi kryesore është krijuar nga ndarja e grup lëndëve të Departamentit ekzistues të Shkencave Juridike dhe bashkimit të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Nga ky bashkim/riorganizim janë krijuar tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si më poshtë :

1) Departamenti i së Drejtës Publike

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **9 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.
- 2 Prof.As.
- 1 PhD.
- 3 Dr.
- 2 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **4 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 Dr.
- 2 Msc.

2) Departamenti i së Drejtës Civile

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **9 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.As.
- 1 PhD.
- 2 Dr.
- 5 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **2 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.As.
- 1 Dr.

3) Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **8 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 PhD.
- 1 Dr.
- 5 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **5 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.
- 2 Prof.As.
- 1 Dr.
- 1 Msc.

Koment:

- Lidhur me numrin e personelit me kohë të plotë të një departamenti (PAE), sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, duhet të jene minimalisht 7 anëtarë me kohë të plotë. Ky kriter plotësohet për të tre departamentet.

Programet e Studimit

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare sipas departamenteve ofron këto programe studimi:

- **Departamenti i së Drejtës Publike**, 1 Bachelor në “Juridik” dhe 1 Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”;

- **Departamenti i së Drejtës Civile**, 1 Bachelor në “Juridik” dhe 1 Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”;

- **Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare**, 1 Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, 1 Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, 1 Master Profesional në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me dy profile: “Studime Mesdhetare”; “Studime Evropiane”.

Koment:

- Titujt e programeve të studimit të paraqitura nga ky fakultet *duken të jenë të përgjithshëm dhe jo tërheqës për tregun e punës*, ku do të dëshironin të punësoheshin të diplomuarit.
- Nuk ka të dhëna se si janë sistemuar studentët që kanë qenë të regjistruar në programet e studimit të ofruara nga njësia e re dhe ajo e riorganizuar, përpara këtij procesi.

V.3 Gjendja e ciklit të tretë të studimeve

V.3.1. Cikli i Tretë i studimeve (studimet doktorale) në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike

Në paraqitjen e drejtimeve të studimeve në ciklin e tretë për fakultetin e ri të krijuar është parashikuar vetëm një fushë e studimeve doktorale në “**Menaxhim dhe E-Qeverisje për Administratën Publike**”.

Koment:

Duket sikur kjo fushë është e lidhur pjesërisht me fushën e studimit të këtij fakulteti. Nga analiza e kapaciteteve akademike duket i vështirë sigurimi i cilësisë.

V.3.2. Cikli i Tretë i studimeve (studimet doktorale) në Fakultetin e Shkencave Ekonomike

Me shkresë përcjellëse, dt. 27.03.2018 të Komisionit të përhershëm të Fakultetit të Shkencave Ekonomike (dokumenti bashkëngjitur me këtë raport), është dërguar propozimi nga Departamenti i Informatikës dhe Kërkimit Shkencor, për hapjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve.

Departamenti i Informatikës dhe Kërkimit Shkencor, si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike pranë UMSH (dokumenti bashkëngjitur me këtë raport), kërkojnë hapjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve në:

1. Studime doktorale në “**Matematikë Bazë dhe Teorike**”,
2. Studime doktorale në “**Sisteme Informatike të Avancuara**”,
3. Studime doktorale në “**Statistikë**”.

Departamenti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë Bankë Kontabilitetit, si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike pranë UMSH, kërkojnë hapjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve në:

1. Studime doktorale në “**Shkenca të Ekonomisë dhe Administrimit të Ndërmarrjeve**”,
2. Studime doktorale në “**Shkenca Ekonomike**”,
3. Studime doktorale në “**Financë, Sisteme Kontrolli dhe Auditimi**”,
4. Studime doktorale në “**Menaxhim projektsh në vepra strukturore dhe infrastrukturore**”,
5. Studime doktorale në “**Menaxhim dhe E-Qeverisje për Administratën publike**”.

Këto propozime nga Departamenti i Informatikës dhe i Kërkimit shkencor, Departamentit të Ekonomisë dhe Departamentit Financë Bankë Kontabilitetit vijnë kryesisht si pasojë e kërkesave aktuale dhe perspektivat për studime doktorale nga kandidatë të interesuar si edhe mbështetur në kapacitetet, që UMSH disponon (dokumenti bashkëngjitur me këtë raport).

Disa problematika të evidentuara nga GVJ lidhur me studimet doktorale:

- a. Shkresa e përcjellë nga Departamenti i Informatikës dhe Kërkimit Shkencor, rezulton e firmosur në fund të saj nga “Departamenti i Ekonomisë”, Dr. Dolantina Hyka. Kjo situatë është e paqartë.
- b. Në propozimet e ciklit të tretë të propozuara nga Departamenti i Ekonomisë, GVJ mendon se ka një përplasje dhe shtim artificial i fushave të studimit, dhe përkatësisht i fushave:
 1. Studime doktorale në “Shkenca të Ekonomisë” dhe Administrimit të Ndërmarrjeve
 2. Studime doktorale në “Shkenca Ekonomike”

Mendimi i ekspertëve është që këto dy fusha mund të përmblihen në një të vetme ose të ndahen veçmas.

- c. Sipas të dhënave të ofruara nga institucioni lidhur me personelin akademik efektiv dhe me kontratë, GVJ konstaton se, Departamenti i Ekonomisë, pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike, nuk ka në përbërjen e tij asnjë personel akademik efektiv (PAE) me titullin “Profesor” dhe vetëm një “Profesor të Asociuar”. Ndërkohë që në Departamentin e Financë Bankë dhe Kontabilitetit është vetëm një personel akademik me titullin “Profesor” dhe dy mbajnë titullin “Profesor të Asociuar”.

Nëse do të bëhet një analizë e studentëve të mundshëm që mund të pranohen, bazuar kjo dhe në kuadrin ligjor në fuqi, këto 2 departamente, që propozojnë 5 profile të shkollës doktorale, mund të integrojnë gjithsej 7 studentë në udhëheqje të një Profesori dhe 10 në udhëheqje të 2 Profesorëve të Asociuar. (Në këtë analizë nuk kemi përfshirë personelin akademik me kontratë PAK).

Qëndrimi i GVJ për këtë situatë është se UMSH nuk disponon kapacitetet e nevojshme akademike për propozimet e 5 profileve të ndryshme të shkollës doktorale.

- d. UMSH ka një Plan strategjik të Zhvillimit, të firmosur nga kryetari i Bordit të Administrimit, por ky dokument është ende i specifikuar si draft deri në licensimin e ciklit të tretë.
- e. Shkresa përcjellëse nga Departamentet për miratimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë daton në 27.03.2018. Gjithashtu edhe vendimi i Komisionit të përhershëm daton po në të njëjtën datë 27.03.2018. (Kohë e shkurtër për analizën e propozimit nga Departamentet).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Aleksandër Xhuvani



Prof. Luljeta Minxhozi



Prof. As. Ana Kapaj Mane

